



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

SSH.05 STANDARDET E KËRKIMIT SHKENCOR DHE
SHËRBIMEVE

SSH.05.01 STANDARDE E PERGJITHSHME TE KERKIMIT SHKENCOR DHE ZHVILLIMIT

SSH.05.01.01 Standardi i udhezimeve te pergjithshme te kerkimit shkencor dhe zhvillimit ne UPT

UPT duhet te kryejë kerkim shkencor bazë ose të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese në mënyrën e përcaktuar në statutin e UPT, sipas objektivave specifike të institucionit në këto drejtime.

Veprimtaria e kerkimit dhe zhvillimit që kryhet në UPT, duhet te synoje dhe në rritjen e cilësisë së arsimimit. Ajo duhet t'u jape studentëve aftësi metodologjike për kerkim, te jape mundësi të vazhdueshme në plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, te përmirësoje kualifikimet e personelit akademik të UPT, si dhe te krijojë mjete materiale për zhvillimin dhe punën në institucion, etj.

Personeli akademik mund të kryejë veprimtari kerkimi e zhvillimi për të tretë, por me kusht:

- a) plotësimin e detyrimeve ndaj UPT, sipas kontratës së punës;
- b) plotësimin e detyrimeve të njësisë përbërëse të UPT për kerkim shkencor, te shprehura me siper. Në mënyrë të detajuar, në statutin e UPT duhet te përcaktohen kushtet për realizimin e veprimtarisë së kerkimit e zhvillimit për të tretë.

SSH.05.01.02 Standardi i veprimtarive kerkimore ne UPT

Veprimtaritë e kerkimit dhe zhvillimit në UPT duhet të sigurojnë integrimin e kerkimit me mësimin.

Temat ose afatet e kerkimit, drejtimet dhe vëllimi i punëve duhet te përcaktohen nga vetë UPT. Këto duhet te përcaktohen mbështetur në nevojat e zhvillimit të vendit, rëndësinë e kerkimit për arsimimin e studentëve, programet e bashkëpunimit shkencor, aftësimin e personelit akademik, si dhe burimet financiare në dispozicion.

UPT duhet te kryejë për të tretë edhe shërbime të ndryshme të kualifikuara, si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime, shërbime klinike, informacioni etj., që rregullohen në statutin dhe rregulloret e tij. Këto veprimtari duhet te kryhen me financime të palëve të interesuara. Të ardhurat nga këto veprimtari duhet te shkojnë tërësisht në favor të institucionit. Kur të ardhurat sigurohen nga veprimtari kerkimore, studimore dhe krijuese të personelit akademik të institucionit, një pjesë e tyre mund të përdoren edhe për shpërblimin dhe motivimin e personelit pjesëmarrës në këtë veprimtari, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

UPT mund te hartojë programe dhe projekte kerkimore të bashkëpunimit me institucione të tjera, publike ose private, brenda dhe jashtë vendit, si dhe me shoqata, fondacione etj.

UPT duhet te beje një raport vjetor për veprimtarinë kerkimore-shkencore ose krijuese të çdo lloji.

SSH.05.01.03 Standardi i planifikimit te veprimtarive kerkimore

Veprimtaritë kerkimore duhet te bëhen mbi bazën e planeve, programeve dhe projekteve të miratuara, sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin "PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE", Nr. 9741. dt. 21.05.2007 ose akte të tjera.

Performanca e punës kerkimore e të gjitha llojeve e niveleve duhet te vlerësohet nga organet drejtuese të UPT.

Programet e studimeve të ciklit të tretë dhe, në masë më të vogël, programet e studimeve të ciklit të dytë duhet te konsiderohen punë kerkimore dhe duhet ti nënshtrohen gjithashtu planifikimit.

SSH.05.01.04 Standardi i misionit, detyrave, organizimit, organeve dhe autoriteteve drejtuese, financimit dhe

veprimtarise financiare, personelit ne Institutin e Energjise, Ujit dhe Mjedisit

Instituti i Energjise, Ujit dhe Mjedisit (INEUM), eshte njesi kryesore e UPT dhe duhet te kete per mision:

- a) kerkimin shkencor, baze dhe te aplikuar;
- b) formimin universitar, te thelluar, te studenteve dhe shkencetareve;
- c) sherbimet per te trete, si dhe transferimin e njohurive dhe teknologjise, ne fushat e energjise, ujit,

mjedisit dhe klimes.

Kerkesat lidhur me detyrat, organizimin, organet dhe autoritetet drejtuese, financimin dhe veprimtarine financiare, si dhe personelin jane dhene te **VKM Nr. 560, dt. 22.08.2007** "Per bashkimin e disa instituteve dhe njesive kerkimore, organizimin e tyre ne Institutin e Energjise, Ujit dhe Mjedisit, prane UPT, dhe funksionimin e Institutit ne periudhen kalimtare".

SSH.05.01.05 Standardi i misionit, detyrave, organizimit, organeve dhe autoriteteve drejtuese, financimit dhe

veprimtarise financiare, personelit ne Institutin e Gjeoshkencave

Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO), eshte njesi kryesore e UPT dhe duhet te kete per mision:

- d) kerkimin shkencor, baze dhe te aplikuar;
- e) formimin universitar, te thelluar, te studenteve dhe shkencetareve;
- f) sherbimet per te trete, ne fushen e sizmologjise dhe transferimit te njohurive te teknologjise, ne fushat e pasurive natyrore, te gjeoriskut, te gjeoinxhinierise dhe gjeoinformacionit.

Kerkesat lidhur me detyrat, organizimin, organet dhe autoritetet drejtuese, financimin dhe veprimtarine financiare, si dhe personelin jane dhene te **VKM Nr. 561, dt. 22.08.2007** "Per bashkimin e disa instituteve dhe njesive kerkimore, organizimin e tyre ne Institutin e Gjeoshkencave, prane UPT, dhe funksionimin e Institutit ne periudhen kalimtare".

SSH.05.02 STANDARDET E PROJEKTEVE TE KERKIMIT SHKENCOR DHE TEKNOLOGJIK

SSH.05.02.01 Standardi i udhezimeve te pergjithshme per projektet e kerkimit shkencor dhe teknologjik

Projektet e kerkimit shkencor dhe teknologjik qe financohen ne UPT, nga buxheti i tij per shkencen mund te propozohen nga **njesite strukturore**, grupe kerkuesish dhe kerkues te veçante te tij, vetem apo ne bashkepunim me institucionet kerkimore te tjera publike.

Projektet e propozuara duhet te mbeshtesin dhe te synojne arritjen e objektivave te kerkimeve shkencore dhe teknologjike te parashikuara ne fushat e percaktuara nga UPT dhe mund te zgjasin per nje periudhe nje deri ne dy vjet.

Administrimi dhe financimi i ketyre projekteve, ne kuadrin e kerkimit shkencor dhe teknologjik ne UPT, duhet te kaloje permes ketyre etapave dhe procedurave:

1. Thirrja per paraqitjen e projekt-propozimeve.
2. Paraqitja e projekt propozimeve.
3. Kontrolli formal.
4. Vleresimi.
5. Percaktimi i projekteve fituese.
6. Lidhja e kontrates.
7. Monitorimi.
8. Raportimi i rezultateve.

SSH.05.02.02 Standardi i thirrjes per paraqitjen e projekt-propozimeve

Thirrja per paraqitje te projekt-propozimeve, drejtuar personelit akademik dhe strukturave te UPT, duhet te permbaje:

- a) Fushat perparaesore te kerkimit shkencor e teknologjik te UPT.
- b) Aktivitetet qe do te financohen.
- c) Pjesemarresit.
- d) Kohezgjatjen e projektit.
- e) Daten perfundimtare te dergimit te projekt-propozimeve.
- f) Adresen e dergimit te projekt-propozimeve
- g) Koston e lejuar te projekteve.

Thirrja duhet te dergohet zyrtarisht ne te gjitha strukturat e UPT (fakultet, institut, departament, etj.), si dhe te publikohet ne te gjitha kendet e njoftimit te UPT, te pakten, nje muaj perpara dates perfundimtare te pranimit te projekt-propozimeve.

SSH.05.02.03 Standardi i paraqitjes se projekt-propozimeve

Projekt-propozimi duhet te hartohet (ne dy kopje) ne perputhje me kerkesat e Formularit te Aplikimit te projektit per kerkim shkencor dhe teknologjik (Aneksi 1 i Udhezimit Nr.7, dt. 16.03.2004 "Per procedurat e administrimit te projekteve te kerkimit shkencor dhe teknologjik qe financohen nga buxheti per shkencen ne shkollat e larta publike") dhe duke mbajtur parasysh sqarimet perkatese, bashkengjitur ketij formulari (Aneksi 1/1). Projekt-propozimi, i shoqeruar me nje kerkese per financim te drejtuesit te grupit kerkimor duhet t'i paraqitet Rektorit te UPT.

Kerkesat per financim projektesh per kerkim shkencor dhe teknologjik ne UPT duhet te paraqiten brenda dates perfundimtare per pranimin e tyre, e cila jepet ne "Thirrjen" e shpalluar nga UPT.

SSH.05.02.04 Standardi i kontrollit formal te projekt-propozimeve

Kontrolli formal i projekt-propozimeve duhet te kryhet nga Grupi i Vleresimit, perberja e te cilit caktohet me urdher te Rektorit te UPT. Anetaret e tij duhet te jene specialiste te shquar ne fushat shkencore te projekt-propozimeve dhe nuk duhet te jene anetare te personelit te projektit, ose te organeve vendim-marrese te strukturave qe e kane propozuar ate, si dhe nuk duhet te kene konflikt interesash, Anetaret e G.V. mund te jene edhe punonjes te institucioneve te tjera te vendit.

Grupi i Vleresimit duhet te kete keto funksione:

- a) te shqyrtoje paraprakisht projekt-propozimet;
- b) te shqyrtoje vleresimet e projekteve nga ekspertet;
- c) te kryeje perzgjedhjen e projekteve fituese mbi bazen e rezultateve te vleresimeve dhe t'i komunikojte zyrtarisht me shkrim Rektorit listen e projekteve fituese;
- d) te monitoroje ecurine e projekteve fituese;
- e) te shqyrtoje rezultatet e pjesshme dhe perfundimtare te arritura ne projekt;
- f) te japë konkluzione per perfundimin e projekteve,

Ne rast se projekt propozimi nuk i permbush kerkesat e standardit te paraqitjes se projekt-propozimeve, te dhene me sipër, ai duhet t'i kthehet autorit/grupit per t'u plotesuar brenda nje afati 5 ditor.

SSH.05.02.05 Standardi i vleresimit te projekt-propozimeve

Projekt-propozimi qe kalon kontrollin formal duhet t'i jepet per vleresim eksperteve te pavarur, specialiste te fushave perkatese, per te bere vleresimin permbajtesor te tij.

Çdo projekt-propozim duhet te vleresohet nga 1-2 eksperte, te cilet duhet te caktohen nga Rektori i UPT. Ata zgjidhen midis specialisteve te fushave perkatese te projekt-propozimeve edhe nga institucione te tjera te vendit dhe nuk duhet te jene pjesetare te personelit te projektit, ose te organeve vendim-marrese te strukturave qe e kane propozuar ate, si dhe nuk duhet te kene konflikt interesash.

Pasi bejne vleresimin e projekt propozimit, ekspertet duhet te paraqesin raportin e vleresimit per pranimin e tij, sipas skedes se vleresimit te projekt-propozimit (Aneksi 2 i i Udhezimit Nr.7, dt. 16.03.2004 "Per procedurat e administrimit te projekteve te kerkimit shkencor dhe teknologjik qe financohen nga buxheti per shkencen ne shkollat e larta publike").

Ekspertet per kryerjen e vleresimit, duhet te shperblehen me vleren e plote te dy diteve te punes te pages se titullit "Profesor per çdo projekt (referuar VKM Nr. 567, dt. 23.10.1995 "Per shperblimin e keshillave, komisioneve dhe ekspertizave te veprimtarise shkencore e teknologjike", VKM Nr. 726, dt. 21.12.2000 "Per pagat e punonjesve te institucioneve buxhetore", VKM Nr. 297, dt. 27.06.2002 "Per nje ndryshim ne pagat e punonjesve te institucioneve buxhetore"). Percaktimi i kushteve per kryerjen e vleresimit te projekt-propozimeve nga ekspertet duhet te percaktohet ne kontraten e lidhur ndermjet tyre dhe Rektorit te UPT, modeli i te ciles jepet ne Aneksin 3 te Udhezimit Nr.7, dt. 16.03.2004 "Per procedurat e administrimit te projekteve te kerkimit shkencor dhe teknologjik qe financohen nga buxheti per shkencen ne shkollat e larta publike".

SSH.05.02.06 Standardi i percaktimit te projekteve fituese

Percaktimi i projekteve fitues duhet te behet nga Grupi i Vleresimit mbi bazen e rezultateve te vleresimit te eksperteve. Lista e projekteve fituese duhet t'i komunikohet me shkrim zyrtarisht Rektorit te UPT, i cili duhet te beje shpalljen e tyre me nje Urdher te veçante. Ai duhet t'u dergohet te gjitha strukturave te UPT dhe MASH (2 kopje).

SSH.05.02.07 Standardi i lidhjes se kontrates

Per projektet fituese qe miratohen per financim, duhet te lidhet kontrata e pergjithshme, sipas modelit te Aneksit 4 (Udhezimi Nr.7, dt. 16.03.2004 "Per procedurat e administrimit te projekteve te kerkimit shkencor dhe teknologjik qe financohen nga buxheti per shkencen ne shkollat e larta publike"). Per projektet qe zgjasin 2 vjet, duhet te lidhen dy kontrata, nje e pergjithshme (Aneksi 4) dhe nje per vitin e pare te zbatimit te projektit (Aneksi 5 i Udhezimit Nr.7, dt. 16.03.2004 "Per procedurat e administrimit te projekteve te kerkimit shkencor dhe teknologjik qe financohen nga buxheti per shkencen ne shkollat e larta publike"). Kontratat duhet te lidhen ndermjet Rektorit dhe drejtuesit shkencor te projektit.

SSH.05.02.08 Standardi i monitorimit

Monitorimi i ecurise se projekteve duhet te kryhet nga Grupi i Vleresimit sipas kriterëve te percaktuara nga UPT.

Drejtoria e Arsimit te Larte dhe Njohjes se Diplomave, prane MASH, duhet te kryeje monitorimin e te gjitha procedurave qe parashikohen ne Udhezimin Nr.7, dt. 16.03.2004 "Per procedurat e administrimit te projekteve te kerkimit shkencor dhe teknologjik qe financohen nga buxheti per shkencen ne shkollat e larta publike".

SSH.05.02.09 Standardi i raportimit te rezultateve

Per rezultatet e arritura ne projekt, drejtuesi i grupit kerkimor duhet t'i paraqese Rektorit te UPT, ne daten 20 janar te vitit pasardhes:

- a) Raportin e pjesshem vjetor per projektet qe zgjasin 2 vjet (Aneksi 6).
- b) Raportin perfundimtar pas mbylljes se projektit (Aneksi 7 i Udhezimit Nr.7, dt. 16.03.2004 "Per procedurat e administrimit te projekteve te kerkimit shkencor dhe teknologjik qe financohen nga buxheti per shkencen ne shkollat e larta publike").

Mbi bazen e raporteve perfundimtare te projekteve, Grupi i Vleresimit duhet te hartoje nje raport perfundimtar, te cilin duhet t'ja paraqese Rektorit.

Pas miratimit te raportit, Rektori duhet te informoje Senatin e UPT dhe MASH duke i derguar dy kopje, nje ne DAL dhe nje ne DKSH.